



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 136, datë 24.11.2022

**PËR  
MBARIMIN PËRPARA AFATIT TË MANDATIT TË KËSHILLTARIT  
Z. NAZMI BODLLI**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1, nënpika 1.1 gërma “b”, neni 49, pika 4 gërma “b”, pika 5, neni 54 pika “j”, nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, dhe në zbatim të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkisë Durrës, me propozim të Komisionit të Mandateve të këshillit,

**KËSHILLI BASHKIAK  
V E N D O S I :**

1. Mbarimin para afatit të mandatit të këshilltarit të Këshillit Bashkiak Durrës z.Nazmi Reshit Bodlli, nga lista shumëemërore të subjektit politik Partia Demokracia Sociale, për shkak të dorëheqjes.
2. Të shpall vakancën në Këshillin Bashkiak Durrës.
3. Për këtë vendim të njoftohet Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

4. Në komisionet e këshillit të bëhen ndryshimet si më poshtë :
- a. Në Komisionin e Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor në vënd të këshilltarit z. Nazmi Bodlli, që ushtronte detyrën si anëtar i këtij komisioni të emërohet këshilltari z. Alban Ramohitaj, përkohësisht deri në marrjen e mandatit të një këshilltari të ri.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sekretari Këshillit Bashkiak.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

### KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 25.11.2022**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës**

Nr. 899/4 prot.

Durrës, më 07.12.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
Durrës**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
Durrës**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.136 datë 24.11.2022  
“Për mbarimin para afatit të mandatit të këshilltarit Z.Nazmi Bodlli”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

